RAPORT STUDIMOR

INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA TIRANË

QENDRA "ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM"

QERSHOR 2022

Raporti studimor

“Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga Bashkia Tiranë”

Qershor 2022

Përgatiti: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Shënim: Ky raport nuk pasqyron pikëpamjet apo qëndrimet e Olof Palme International Centre, National Endowment for Democracy apo Embassy of Sweden in Tirana.

Tabela e përmbajtjes

I. HYRJE 4
II. LISTA E SHKURTIMEVE 6
III. PROFILI I BASHKISË TIRANË 7
IV. METODOLOGJIA 9
***V.* ANALIZË E FORMAVE TË NJOFTIMIT, INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK 10**
VI. GJETJET NGA ANKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E BASHKISË TIRANË 12
Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore 12
Kuadri Ligjor për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin në Nivel Vendor 13
Koordinatori për Konsultimin Publik dhe Transparencën 14
Instrumentat për Njoftimin e Qytetarëve 14
Regjistri Elektronik 15
Instrumentat e Informimit 16
Aksesi i qytetarëve në dokumenta 19
Hartimi i Programit të Transparencës 19
Trajnimet mbi Detyrimet Ligjore mbi Informimin Publik 20
VII. GJETJET NGA AKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E KËSHILLIT BASHKIAK 21
Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore 21
Njohja e bazës Ligjore për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin 22
Rregulloret e Këshillit Bashkiak 22
Bashkëpunimi mes Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak 23
Publikimi i Njoftimeve për Mbledhjet e Këshilli Bashkiak 23
Publikimi i Akteve të Këshillit Bashkiak 23
Regjistri Elektronik 24
Programi i Transparencës 24
Trajnimet në Lidhje me Detyrimet Ligjore dhe Informimin Publik 24
VIII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME 25
IX. REFERENCA 27
X. ANEKS 1 PYETËSOR ME DREJTUES DHE NËPUNËS TË BASHKISË 28
XI. ANEKSI 2 PYETËSOR ME KËSHILLIN BASHKIAK 32

I. HYRJE

Raporti studimor *"Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor"* realizohet në kuadër të projektit "Përballja e Ofertave Politike – POP". Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: "*Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social*" dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti "Përballja e Ofertave Politike" monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti Rrjeti POP, synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatat e Rrjetit POP gjatë periudhës maj -qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse ne Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetaret pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhet të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet te punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t'u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe

llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

***Organizatat partnere të rrjetit janë**: Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra "Hapa të Lehtë" Vau i Dejës.*

II. LISTA E SHKURTIMEVE

BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor
KB	Këshilli Bashkiak
KKQV	Komisione Këshillimore Qytetare Vendore
GADC	Gender Alliance Development Center
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NED	National Endowment for Democracy
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Plame International Centre
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
QV	Qeverisje Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale

III. PROFILI I BASHKISË TIRANË

Zona gjeografike: Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit është 502 banorë/ km^2 ndërsa sipas Regjistrit Civil, densiteti është 682 banorë km^2.

[1]Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, gjatë vitit 2020, Bashkia e Tiranës e përbërë nga 24 njësitë administrative me një sipërfaqe gjithsej prej 1,111 km^2 ka:

Popullsi prej 850,530 banorësh nga 842,019 banorë një vit më parë ose ndryshim 1% krahasuar me vitin e kaluar

Dendësi popullsie prej 766 banorë/km2

Mosha mesatare: 37 vjeç

Gjinia: 50.5% të popullsisë femra, ose raport gjinor prej 97.9 meshkuj për çdo 100 femra

Familjet: 301,014 familje ose 271 familje për km2 me rreth 2.8 anëtarë/familje

Zhvillimi i territorit: Ndarja administrative e Shqipërisë ka pësuar ndryshime të vazhdueshme si për sa i përket shtrirjes gjeografike, ashtu edhe funksioneve të strukturave. Në 31 korrik 2014, me vendim të Parlamentit Shqiptar, u miratua organizimi i ri administrativo-territorial që e ndan vendin në 12 qarqe, 61 bashki dhe nën ndarjet të tjera të parashikuara në ligjin 115/2014 "Për ndarjen administrativo - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Me ligjin e ri, Bashkisë së Tiranës iu bashkuan 13 ish-komuna përveç 11 Njësive Bashkiake që ekzistonin deri atëherë. Deri në vitin 2014, Bashkia e Tiranës zinte një sipërfaqe prej rreth 41.8 km^2 dhe përfaqësonte 3.4 % të rrethit të Tiranës. Me ndarjen e re administrative në vitin 2015, Bashkia e Tiranës ka rritur me 27 herë territorin e saj dhe ka afërsisht një sipërfaqe rreth 1,111 km^2. Ndërsa me vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave numër 360 i datë 29 Maj 2019 territori i Bashkisë Tiranë arrin një sipërfaqe prej 1,120.91 km^2.

Bashkia e Tiranës ndodhet në qarkun e Tiranës ku përveç saj janë dhe katër bashki të tjera, Kamza, Kavaja, Rrogozhina dhe Vora. Në përbërjen e vet Bashkia e Tiranës ka 11 njësi administrative urbane, 13 njësi rurale dhe 3 lagje, lista e të cilave mund të aksesohet **këtu**

[1] Bashkia Tiranë – Open data: https://opendata.tirana.al/?q=popullsia-e-tiran%C3%ABs-2020

Administrata e Bashkisë Tiranë:

Viti 2014 shënoi ndryshime në organizimin administrativo-territorial të Shqipërisë. Më 31 korrik 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit organizon territorin dhe qeverisjen vendore në vetëm 61 bashki.

Synimi kryesor i Reformës Administrative- Territoriale:

- Përmirësimi i qeverisjes,
- Aksesi i plotë dhe cilësor i qytetarëve në shërbime publike,
- Demokracia lokale,
- Zhvillimi ekonomik lokal në dy drejtime: (1) konsolidimin e territorit (bashkim të njësive vendore si në nivelin e parë – bashki/komuna dhe në nivelin e dytë - qarqet), dhe (2) ndarjen dhe qartësimin e funksioneve dhe kompetencave midis niveleve të qeverisjes me synim thellimin dhe konsolidimin e decentralizimit.

Ndërkohë që Struktura Organizative e detajuar sipas departamenteve, drejtorive etj gjendet duke klikuar [këtu]



IV. METODOLOGJIA

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Tiranë janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: ***a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.***

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimmarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", Ligji Nr. 146/2014 *"Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*", Ligji Nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit",* etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikat e përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjitha hallkat e veta (*hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e mjetet që do të përdoreshin për kryerjen e tij*). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithë përfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumë vjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmbyllëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

V. ANALIZË E FORMAVE TË NJOFTIMIT, INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

(*website, facebook, tabelat e njoftimeve publike, regjistri elektronik)*

Komunikimi i vazhdueshëm në institucionet publike është një ndër elementët kryesorë për të krijuar një marrëdhënie të mirë mes institucionit dhe publikut. Institucione të ndryshme përdorin mënyra të ndryshme për të komunikuar me publikun qoftë në funksion të promovimit të aktiviteteve të tyre apo në funksion të përmbushjes për të drejtën për informim.

Ndër elemetët kyç për të mbajtur një publik të informuar janë edhe mediat e ndryshme të cilat ndiqen nga qytetarët. Përdorimi i teknologjive të reja dhe mediave sociale ka shtuar ndjeshëm nivelin e komunikimit midis institucioneve dhe publikut, aktorëve politikë e publikë me qytetarët dhe anasjelltas. Në kohët që jetojmë mediat sociale janë bërë një nga mënyrat më të rëndësishme të informimit. Bashkia Tiranë mediat sociale i shikon si një mënyrë komunikimi efektive.

Mediat sociale në Bashkinë Tiranë menaxhohen nga Drejtoria e Komunikimit Dixhital pranë kësaj bashkie. Komunikimet e ndërtuara në mediat sociale e kanë kapërcyer me kohë detyrimin e informimit të publikut, sot bëhet falë për ndërveprim. Kjo drejtori dhe stafi i saj shërbejnë si një drejtëz shoqërore mes institucionit dhe qytetarëve, duke bërë ndërmjetësimin kur ka kërkesa, ankesa apo vërejtje dhe më pas ato kalohen në drejtoritë përkatëse.

Zakonisht publikimet janë të ndara në tre blloqe kryesore:

1. Axhenda e kryetarit apo/dhe nënkryetarëve të bashkisë
2. Njoftimet apo puna e institucioneve të varësisë
3. Eventet në qytetin e Tiranës

Faqja Web e Bashkisë Tiranë

Kjo faqe është porta kryesore e komunikimit dhe informimit të qytetarëve. Është një faqe interaktive e cila të ndihmon në navigim dhe është e ndarë në 7 seksione kryesore, ku gjendet informacion për Administratën; Qytetarët; Kulturën; Turizmin; Sportin; Ekonominë dhe Biznesin, Zëri yt dhe Harta naviguese.

Sipas monitorimit të kryer që prej vitit 2019 por edhe në muajt e fundit me qëllimin e përpilimit të këtij raporti, secila prej kategorive ka informacion të qartë dhe udhëzues sipas kategorive. Është një faqe miqësore në përdorim dhe në brendësi të saj kategoritë janë të ndara qartësisht për vizitorët.

Përveç informacionit të lajmeve të ndryshme të bashkisë, në brendësi ka aplikime, raporte, kontakte dhe informacion sa i përket mënyrës së kontaktit për departamente apo drejtori të ndryshme në fushat ku bashkia ushtron veprimtarinë e saj.

Në faqen zyrtare të bashkisë Tiranë është i ndërthurur edhe informacioni në lidhje me Këshillin Bashkiak të kësaj bashkie, me kategoritë vijuese:

- Përbërja e këshillit bashkiak
- Rregullorja
- Njoftimet
- Vendimet
- Buletinet
- Regjistri elektronik i kërkesave dhe ankesave

Në faqen zyrtare të bashkisë Tiranë një kategori të veçantë zë edhe programi i modelit të transparencës për qytetarët, me përbërje si vijon:

- Organizimi dhe funksionimi i bashkisë
- Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare
- Kërkesat për informacion, të cilat janë të publikuara në faqen web dhe mund të shkarkohen në format excel çdo dy muaj.
- Informacion mbi shërbimet që ofron bashkia
- Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore
- Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje

Në bashkërendim, bashkia Tiranë përdor metoda të ndryshme për informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar si:

- Lajmërimi publik i afishuar në ambjentet e bashkisë
- Lajmërime në media (sipas rasteve)
- Lajmërime në web dhe media sociale
- Nëpërmjet platforëms tiranaime.al
- Nëpërmjet numrit të gjelbër 08000 888 – në rastet kur ka telefonata nga qytetarët që kërkojnë informacion
- Lajmërime nëpërmjet postës – në rate të çështjeve të veçanta
- Zyrës së informacionit
- Plaftformës https://opendata.tirana.al/
- Zyra me një ndalesë
- Zyra e Koordinatorit për të drejtën e informimit
- Zyra e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik
- Botimet e bashkisë dhe këshillit bashkiak
- Këndet e informimit në ambjentet e njësive administrative
- Regjistri elektronik

VI. GJETJET NGA ANKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E BASHKISË TIRANË

Kuadri ligjor në fuqi parashikon një sërë detyrimesh dhe përgjegjësish në lidhje me format dhe mjetet që institucionet publike duhet të vënë në dispozicion për të ofruar dhe mundësuar pjesëmarrjen e publikut dhe grupeve të interesit në procesin e informimit, njoftimit dhe përfshirjes së tyre në konsultim e vendimmarrje.

Anketimi me përfaqësues të Bashkisë Tiranë përfshiu 7 intervista me drejtues të sektorëve të ndryshëm të bashkisë si edhe intervista me 30% të administratorëve të njësive administrative pranë kësaj bashkie, me një total prej 15 takimesh dhe marrje informacioni të detajuar. Drejtoritë e përfshira kanë të bëjnë me procese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët.



Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore

Në zbatim të detyrimeve të parashikuar në Ligjin 146/2014 "*Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*" në Bashkinë Tiranë të anketuarit janë pyetur mbi rëndësinë e njoftimit në vendimmarrjen vendore. Siç vërehet edhe nga përgjigjet, rëndësia e këtij komponenti domethënës të mirëqeverisjes në nivel vendor për rreth 73% të të anketuarve që e cilësojnë si një proces shumë të rëndësishëm. Ndërkohë që edhe në analizat apo diskutimet në fokus grupe me komunitetin, edhe qytetarët e vlerësojnë si mjaft të rëndësishëm këtë aspekt, megjithëse ka qytetarë të cilët nuk kanë informacionin e duhur sa i përket procesit se si bashkia Tiranë e zbaton këtë detyrim ligjor. E drejta për informim është e garantuar në përputhje me Ligjin 119/2014, ku secili ka të drejtën dhe mund të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore dhe insitucionet publike duhet të garantojnë transparencën dhe të drejtën e informimit për të gjithë. Ky proces është vlerësuar nga rreth 87% e të anketuarve si shumë i







rëndësishëm për tu aplikuar. Dhe po njësoj, është vlerësuar edhe rëndësia e konsultimit dhe bashkia Tiranë është gjithmonë e angazhuar që të nxisë procese gjithëpërfshirëse për konsultimin me publikun. Bazuar në ligjin nr. 146/2014 "*Për njoftimin dhe Konsultimin publik", si dhe Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"* bashkia Tiranë ndër mekanizmat e përdorur ka edhe 2 koordinatorë pjesë të administratës që janë:

- Koordinatorja për njoftimin dhe konsultimin publik
- Koordinatorja për të drejtën e informimit.

Kuadri Ligjor për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin në Nivel Vendor

Është e rëndësishme që punonjësit e pushtetit vendor të jenë të pajisur me njohuritë e duhura dhe në përputhje me detyrimin ligjor për ushtrimin efektiv të funksionit të tyre publik.

Për këtë arsye të intervistuarit u pyetën për njohjen që kanë për kuadrin ligjor që lidhet me njoftimin, informimin dhe konsultimin në nivel vendor. Përgjigjet tregojnë që 100% e të intervistuarve e njohin shumë mirë ligjin dhe punojnë për zbatimin e tij. Gjithashtu ata e kanë vlerësuar pozitivisht në masën 100% këtë ligj si të qartë dhe të plotë, duke theksuar vetëm që ai duhet zbatuar në përpikmëri nga çdo departament, drejtori apo institucion që përcakton ligji. Por, që ligjet të jenë efektive dhe të mirëzbatueshme, ato duhet të gëzojnë jo vetëm njohjen dhe kuptueshmërinë e profesionistëve të cilët i përdorin ato në punën e përditshme por edhe edhe të zbatohen apsi qytetarët shpesh ankohen për zbatimin e mirë dhe të barabartë të ligjit.

Koordinatori për Konsultimin Publik dhe Transparencën

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave. Konkretisht, ligji 146/2014 "*Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*", ligji nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, "*Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike*." Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm dhe detyra të përcaktuara qartë në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike. Të intervistuarit në bashki janë përgjigjur në masën 100% për ekzistencën e koordinatorit për konsultim publik dhe për transparencën. Të dhënat e koordinatorit duhet të afishohen publikisht, në faqen zyrtare të bashkisë. Nga monitorimet e kryera në faqen zyrtare web të Bashkisë Tiranë janë të publikuara të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik, gjithashtu edhe të dhënat e koordinatores për të drejtën e informimit. Ekzistenca e të dyja koordinatoreve njihet nga të gjithë të intervistuarit, si edhe profilet e punës që realizohen prej tyre, duke specifikuar këtu se ato mbulojnë vetëm detyrat dhe përgjegjësitë që parashikon ligji për pozicionin. Gjithashtu https://tirana.al/kategori/konsultimi-publik është një prej vegëzave të faqes web të bashkisë Tiranë e cila ofron informacion sa i përket konsultimit publik dhe angazhimit të qytetarëve.

Instrumentat për Njoftimin e Qytetarëve

Për njoftimin e qytetarëve në lidhje me çështje të ndryshme Bashkia Tiranë duket se përdor një tërësi formash në mënyrë që informacioni të shkojë tek çdo target grup. Vërehet se format më të përdorura janë lajmërimet e afishuara në ambjentet e bashkisë apo/dhe Njësive Administrative, si dhe në mediat sociale, web, takimet dhe dëgjesat. Sipas të intervistuarve lajmërimet individuale nëpërmjet postës dhe postës elektronike kryhen për çështje apo njoftime specifike për persona të caktuar dhe përdoren në raste të caktuara. Numri i njoftimeve të publikuara në tabelat e lajmërimeve ndryshon nga

njësia në njësi, apo në bashkinë Tiranë. Sipas informaconit nga kjo e fundit, në vitin 2021 janë publikuar rreth 3600 shpallje, ndërkohë që sipas informacioneve të përfituara nga njësi të ndryshme administrative kjo shifër varion nga 1000 – 8000 njoftime dhe publikime në vit, shifër kjo e cila varet edhe nga madhësia e njësisë dhe dendësia e popullsisë.

Regjistri Elektronik

Mbajtja dhe publikimi i regjistrit elektonik është një detyrim ligjor që duhet përmbushur nga çdo institucion publik, por që në praktikë nuk gjen zbatim në çdo bashki në vend. Duket që ky nuk është rasti i Bashkisë Tiranë dhe kjo është një praktikë e mirë, e cila duhet të vlejë si shembull pozitiv për t'u përdorur dhe vënë në zbatim.

Gjatë anketimit ndaluam në disa pika kryesore sa i përket këtij regjistri. Të gjithë të anketuarit ishin në dijeni të ekzistencës së tij, rreth 70% ishin të sigurtë që ai përditësohej në mënyrë të rregullt. Edhe nga monitorimi i kryer në linkun përkatës, ky regjistër përditësohej rregullisht dhe në kontrollin e fundit, publikimi i fundit datonte më 22.6.2022 dhe me datë përgjigje 30.6.2022



Përgjegjës për përditësimin e tij është Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit si edhe struktura të tjera që kanë detyrime ligjore të konsultojnë projektvendimet, strategjitë etj. Informacion ky i cili në fakt u përçua vetëm nga 60% e të anketuarve, ndërsa 40% e tyre nuk kishin dijeni se kush ishte përgjegjës për përditësimin e tij. Nga monitorimet në faqen web të bashkisë regjistri elektronik është i publikuar në: https://cloud.tirana.al/index.php/s/kPt8X7H3kBJ4gmF dhe është i ndarë në ankesa, kërkesa dhe vërejtje apo të tjera. **Ai përmban**:

- Numrin rendor;
- Llojin e shkresës (kërkesë, ankesë, verëjtje);
- Kodin e regjistrimit;
- Përshkrimin e çështjes;
- Datën e regjistrimit në protokollin e bashkisë;
- Organi/drejtoria/sektori që i është drejtuar ankesë/kërkesa;
- Dërgimin për mendim në komisionin përkatës të Këshillit (që nga hulumtimi i të gjitha ankesave/kërkesave vitit 2022 – ky nuk aplikohej);
- Data e publikimit në regjistrin elektronik të kërkesave/ankesave;
- Data e kalimit në këshill për shqyrtim;
- Komenti nëse është mbeshtetur nga këshilli apo jo;
- Data e zbatimit nga Ekzekutivi;

- Efekti financiar;
- Sa kohë u shpenzua për dhënien e përgjigjes (numri i ditëve)
- Data dhe numri i përgjigjes;
- Komente;
- Nënshkrimi i sekretarit.



Instrumentat e Informimit

Sa i përket mjeteve që përdor Bashkia Tiranë për informimin e qytetarëve, vihet re rëndësia e Zyrave me Një Ndalesë, faqja zyrtare e bashkisë si dhe mediat sociale pasi 100% e të intervistuarve i shohin si mjete të rëndësishme për informimin e qytetarëve. Më pas si format më të përdorura për informimin e qytetarëve 85% janë votuar këndet e informimit në ambientet e bashkisë apo/dhe njësive administrative si dhe 75% botimet e bashkisë.

Ndërkohë që përvec sa më sipër, bashkia Tirana operon edhe me Onestop shop "One-Stop-Shop" (OSS) përfaqëson çdo zyrë ku qytetarët dhe/ose bizneset mund të aplikojnë për të përfituar një shërbim të caktuar. Modeli OSS është zgjeruar në mënyrë progresive në shumë sektorë të ndryshëm dhe mundëson portën e vetme për të gjithë ndërveprimin midis qytetarëve/ bizneseve dhe Administratës Publike.

Një zyrë ndodhet pranë bashkisë dhe muajt e fundit janë shtuar edhe tre zyra të tilla në njësitë administrative nr. 3;8;10 si edhe pritet të finalizohet hapja e dy të tjerave në Farkë e Kashar, duke e lehtësuar edhe më shumë menaxhimin e informacionit dhe shërbimeve për qytetarët. Momentalisht ky aplikacion përdoret vetëm për punonjësit e bashkisë për të parë ecurinë e

zgjidhjes së një kërkese apo të ngjashme. Sipas zyrtarëve të bashkisë Tiranë, perspektiva e ardhshme është që qytetarët të kenë vetë akses në këtë portal dhe të gjurmojnë ecurinë dhe statusin e kërkesës së tyre. Nga ndryshimet e fundit prej 1 majit të këtij viti, mbi 95% e shërbimeve publike të ofruara nga shteti do të ofrohen online në 'E-Albania', me qëllim mënjanimin e sporteleve në të gjithë Shqipërinë. Për këtë detaj pyetëm edhe përfaqesues të bashkisë Tiranë, për të kuptuar më shumë se si po kalon tranzicioni dhe informacioni tek qytetarët. Nga të dhënat e mbledhura, rezulton se kjo bashki ka bërë një ndarje të sporteleve fizike sipas njësive administrative, por në çdo rast, zyra e informacionit do të shërbejë për ofrimin e informacionit dhe udhëzimeve për qytetarët. ***Një pasqyrim i kësaj ndarje renditet si vijon më poshtë:***

Sportelet e ofrimit të shërbimit të gjendjes civile				
Qarku	**Bashkia Tiranë**	**Vendndodhja**	**Sportel Sherbimi Fizik**	**Sportel Sherbimi Online**
Tiranë	Bashkia Tiranë Qender	Bashkia Tirane	3	0
	Njesia Administrative nr 1	NJA 1	1	3
	Njesia Administrative nr 2	NJA 2	1	4
	Njesia Administrative nr 3 dhe nr 4	NJA 4	1	6
	Njesia Administrative nr 5	NJA 5	1	3
	Njesia Administrative nr 6	NJA 6	1	4
	Njesia Administrative nr 7	NJA 7	1	4
	Njesia Administrative nr 8 dhe nr 9	NJA 9	1	6
	Njesia Administrative nr 10	NJA 10	1	2
	Njesia Administrative nr 11	NJA 11	1	4
	NjA Dajt/ Shengjergj /Lagje 12/Zall Bastar	Lagje 12	1	3
	Lagje 13	Lagje 13	1	0
	Lagje 14	Lagje 14	1	0
	NJA Farke/Baldushk/Petrele /Berzhite/Krrabe	NJA Farke	1	4
	NJA Vaqarr/Peze/Ndroq	NJA Vaqarr	1	2

	NJA Kashar	NJA Kashar	1	0
	NJA Zall-Herr	NJA Zall-Herr	1	0
	Total Sportele		19	45

Sipas monitorimeve edhe aplikacioni https://opendata.tirana.al/ është një filozofi që mbështet shpërndarjen dhe publikimin e lirë të të dhënave pa kufizime ligjore, patenta apo mekanizma të tjerë kontrolli që bashkia Tiranë përdor.

Sipas të dhënave publike, Trana u bë qyteti i parë në Shqipëri, prej prillit 2017, me një bazë të dhënash për punët publike dhe shërbimet që ofron Bashkia e Tiranës, në funksion të rritjes së transparencës ndaj qytetarëve, por edhe menaxhimit më të mirë të kohës dhe parave të taksapaguesve. Bashkia e Tiranës, ka publikuar online portalin "opendata.tirana.al", i cili rrit transparencën dhe u ofron qytetarëve të dhëna të ndryshme për punët, investimet dhe çdo shërbim që kryhet në qytet. Programi vlerësohet si një hap drejt përmirësimit të shërbimit ndaj qytetarëve me një kosto më të ulët dhe rritjes së transparencës për aktivitetin që kryen Bashkia e Tiranës.

Struktura përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave është Drejtoria e të Dhënave (DDH), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe të Dhënave. Platforma është bazuar në projektin me burim të hapur DKAN dhe organizohet në tre nivele:

1) Kategori, të cilat janë bazuar në funksionet që përmbush bashkia me ligj. Një kategori përmban një ose disa dataset-e;
2) Dataset-e të cilat janë një grupim të dhënash prandaj quhen ndryshe "Fashikujt e të dhënave" dhe në përbërje të tyre ndodhen një ose disa burime;
3) Burime që mund të jenë file të tipeve të ndryshme si csv, doc, ods, zip, json etj dhe në platformën tonë i referohet një periudhe të caktuar kohore për dataset-in ku bën pjesë.

Krahas kategorive, fashikujt e të dhënave mund të identifikohen edhe nëpërmjet grupeve. Një grup përfaqëson institucionin që siguron të dhënat. Blogs ose Ditarë janë informacione narrative që shpërndahen me qëllim informimin e përdoruesve për përkufizime, legjislacione, procedura etj, që zbatohen në mbledhjen, grupimin dhe publikimin e të dhënave.



Të anketuarit janë pyetur për sfidat dhe vështirësitë që ndeshin në njoftimin dhe informimin e publikut. Ata janë shprehur se komunikimi me qytetarët duhet të jetë gjithmonë i thjeshtë, i strukturuar dhe i kuptueshëm. Njoftimi realizohet i plotë në forma të ndryshme të komunikimit, por një aleat i rëndësishëm janë edhe administratorët në njësitë administrative të cilët përçojnë mesazhin tek komuniteti si edhe ndërlidhësit apo administratorët e pallatave sipas njësive.

Aksesi i qytetarëve në dokumenta

Të pyetur për aksesin që kanë qytetarët për të marrë dokumenta apo informacione të ndryshme në masën 100% punojësit e institucionit janë përgjigjjur se në Bashkinë Tiranë informacioni për qytetarët është lehtësisht i aksesueshëm. Informacionet të cilat kërkohen nga Bashkia Tiranë ofrohen pa pagesë me përjashtim të rasteve kur me ligj apo VKB është përcaktuar tarifë për një shërbim të caktuar. Po ashtu, informacioni i kërkuar me rrugë elektronike i jepet çdo qytetari pa pagesë. Nga një vëzhgim i faqes zyrtare web të Bashkisë janë të publikuara të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak. Të intervistuarit pohojnë në masën 100% se realizohet publikimi i akteve në faqen zyrtare, si dhe afishimi i tyre në vende të caktuara për çështje të ndryshme.

Hartimi i Programit të Transparencës

Transparenca dhe llogaridhënia janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë dhe ndërtimit të besimit me komunitetin. Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", dhe Ligji Nr. 146/2014 "*Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*" u

garantojnë qytetarëve akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare. Nëpërmjet Modelit të Programit të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore, Bashkia Tiranë vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Sipas monitorimit të kryer në https://tirana.al/kategori/programi-transparences vihet re se tër t'i bërë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm kategoritë e informacionit, të parashikuar shprehimisht në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (në vijim ligji), janë përshtatur me kontekstin e vetëqeverisjes vendore; me misionin, detyrat, funksionet dhe kompetencat e bashkisë.

Në këtë optikë tabela përmbledhëse e Programit është ndarë në 7 fusha kryesore:

- Fusha 1 - Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë
- Fusha 2 - Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare
- Fusha 3- Për kërkesat për informim
- Fusha 4 - Mbi shërbimet që ofron bashkia
- Fusha 5 - Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore
- Fusha 6 - Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje
- Fusha 7 - Informacion tjetër (*Bashkia vë në dispozicion të qytetarëve informacion të ndryshëm të tillë si proceset e integrimit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime dhe vlerësime të ndryshme, veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës etj; vetë-organizimi komunitar etj.)*



Trajnimet mbi Detyrimet Ligjore mbi Informimin Publik

Të pyetur nëse kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut, rreth 67% e të intervistuarve janë përgjigjur se kanë zhvillluar trajnime të tilla dhe pjesa tjetër kishin marrë trajnime në mënyrë të rregullt por nuk ishin të qartë mbi tematikën. Po ashtu, ata janë shprehur se ka gjithmonë nevojë për të tilla, trajnime në organizimin e tryezave të diskutimit duke ndarë eksperiencat apo praktikat e mira apo për të bërë propozime konkrete për përmirësimin e akteve nënligjore. Pranë bashkisë Tiranë është ngritur prej disa vitesh Drejtoria e Trajnimit dhe Zhvillimit për

administratën e kësaj bashkie. Sipas një kalendari të caktuar dhe nevojave të stafit, organizohen trajnime në mënyrë të rregullt disa herë gjatë vitit me ekspertë ToT (Trajnerë të Trajnerëve). Gjithashtu në bazë të një pagese të paracaktuar për trajnime të ndryshme të organizuara nga ASPA, bashkia Tiranë përzgjedh disa punonjës dhe ju paguan trajnimin dhe mbulon kohën e nevojshme që ata/ato kanë nevoje për të marrë trajnimin e plotë. Është e vetmja bashki, e cila në buxhetin e saj ka të paracaktuar një zë për këtë çështje. Fokusi për të trajnuar stafin por edhe administratorët e njësive administrative të Tiranës, mbetet shumë i lartë dhe realizohet në mënyrë periodike sipas fushave dhe çështjeve të ndryshme, për të cilat apo me të cilat bashkia e Tiranës lidh bashkëpunime të ndryshme.

VII. GJETJET NGA AKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E KËSHILLIT BASHKIAK

Anketimi me Këshillin Bashkiak Tiranë përfshiu 6 përfaqësues. Të intervistuarit përfaqësojnë komisione apo pozicione të caktuara të cilat kanë të bëjnë me procese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë, përfshirë Këshilli Bashkiak Tiranë për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore

Të intervistuarit e Këshillit Bashkiak Tiranë e vlerësojnë në masën 100% rëndësinë e njoftimit, informimit dhe konsultimit në vendimarrjen vendore. Sipas tyre, njoftimi i publikut për mbledhjet e Këshillit realizohet në forma të ndryshme duke e shikuar si një element shumë të rëndësishëm pjesëmarrjen e qytetarëve në procese të ndryshme konsultuese.

Këshilltarët e pyetur e vlerësonin si shumë të rëndësishme pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset konsultuese, duke vënë theksin në transparencën dhe politikbërjen cilësore. Sipas të intervistuarve sigurimi i pjesëmarrjes qytetare është detyrim ligjor, por po kaq e rëndësishme është edhe për veprimtarinë e çdo individi të Bashkisë Tiranë.

Njohja e bazës Ligjore për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin

Këshilli Bashkiak ushtron të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e tij në kuadër të misionit të vetëqeverisjes dhe autonomisë vendore dhe siguron qeverisjen e efektshme, efikase në një nivel sa më afër qytetarëve. Ndërkohë që Bashkia është organi ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak është ai legjislativ, është e thelbësore njohja e thellë e kuadrit ligjor nga ana e atyre që marrin vendimet më të rëndësishme për jetën e qytetarëve, pra këshilltarëve. Për këtë arsye, u pyetën këshilltarët për njohuritë e tyre mbi bazën ligjore përkatëse dhe vlerësimin e tyre për të.



Baza ligjore referuese njihet nga të intervistuarit e Këshillit Bashkiak Tiranë, edhe pse në përgjigjet e tyre shpesh vërehet referim në akte ligjore të ndryshuara apo të shfuqizuara. Gjithsesi, të intervistuarit deklarojnë se janë trajnuar për decentralizimin dhe vetëqeverisjes vendore. 87% e tyre deklarojnë që legjislacioni është i qartë dhe i plotë dhe 13% përgjigjen që është i qartë, por jo i plotë.

Rregulloret e Këshillit Bashkiak

Përgjatë viteve të fundit, çdo këshill bashkiak në vend ka zhvilluar dhe miratuar disa rregullore, të tilla si rregullorja e përgjithshme e këshillit bashkiak, rregullorja për marrëdhëniet me publikun dhe median, rregullorja për etikën dhe rregullorja e kërkesë-ankesave. Këto instrumenta synojnë të rregullojnë dhe lehtësojnë procese dhe funksione të caktuara të këshillit bashkiak. Këshilli Bashkiak i Tiranës funksionon vetëm me rregulloren e brendshme e cila është përditësuar dhe mbulon çdo nevoje rregullatore të funksionimit të këshillit pranë kësaj bashkie. 85% e pjesëmarrësve në anketim e vlerësojnë rregulloren e Këshillit Bashkiak si të qartë dhe të plotë.



Bashkëpunimi mes Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak

Të intervistuarit janë përgjigjur në masën 100% pozitiv dhe vlerësues sa i përket bashkëpunimit mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Tiranë për procesin e njoftimit dhe informimit me publikun. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit duke nisur me ato formale nëpërmjet e-mail, kërkesave për informim, tryeza diskutimi apo shpërndarje e informacioneve në mediat sociale për informim të qytetarëve.

Publikimi i Njoftimeve për Mbledhjet e Këshilli Bashkiak

Të intervistuarit u pyetën gjithashtu nëse publikohet njoftimi për mbledhjen e këshillit në vende të caktuara për këtë qëllim dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore. 100% e të përgjigjeve pohojnë publikimin e këtyre njoftimeve. Njoftimi për mbledhjen e Këshillit bëhet publik ne vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes Sipas monitorimit të realizuar njoftimi për mbledhjen bëhet rreth 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës. https://tirana.al/artikull/njoftimet
Për vitin 2021 në faqen web në seksionin e Këshillit bashkiak janë njoftuar 16 mbledhje të këtij organi, mbledhje dhe vendime këto që janë monitoruar edhe në kuadër të Kontratës Sociale sipas datave.

Publikimi i Akteve të Këshillit Bashkiak

Neni 18 i Ligjit 139/2015 referon në mënyrë të drejtpërdrejtë Ligjin 119/2014 teksa përcakton shprehimisht se: "*Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim*".

Nga monitorimet e kryera në faqen web të bashkisë Tiranë, seksioni i Këshillit Bashkiak https://tirana.al/kategoria-e-publikimit/vendime-keshilli-bashkiak janë të publikuara të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak. Po ashtu, të gjithë të anketuarit e kanë pohuar këtë. Sipas monitorimit, vendimet e fundit mbajnë datën 14 qershor 2022. Gjithashtu në bazë të monitorimit të mbledhjeve, ato transmetohen edhe live në faqen zyrtare të këtij Këshilli në Facebook.

Sipas monitorimit, Këshilli bashkiak Tiranë, publikon buletine informative çdo dy muaj, mbi aktivitetet e këtij organi. Publikimi i fundit i referohet periudhës maj – qershor 2022.



Regjistri Elektronik

Këshiltarët janë pyetur gjithashtu për regjistrin elektronik, ku të gjithë janë përgjigjur se janë në dijeni të publikimit të tij në faqen web të Bashkisë Tiranë. Të gjithë të anketuarit janë në dijeni dhe e njohin Regjistrin Elektronik.

Programi i Transparencës

Publikimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës në faqen zyrtare të web të Bashkisë përbën një detyrim ligjor për organet publike që rrjedh nga Ligji 119/2014. Programi i Transparence përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të ofrohet nga bashkia pa kërkesë. Këshilltarët e intervistuar u shprehën në masën 100% se janë në dijeni të Programit të publikuar të Transparencës në faqen web të Bashkisë.

Trajnimet në Lidhje me Detyrimet Ligjore dhe Informimin Publik

Për pyetjen a kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore dhe informimin publik të gjithë janë përgjigjur se kanë marrë. Por, u shprehën se gjithmonë ka nevoja për trajnime të ndryshme, për shkëmbim eksperiencash me këshilla bashkiak në shtete të cilat kanë demokraci vendore të konsoliduar.

VIII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Proceset e njoftimit, informimit dhe konsultimit publik vlerësohet nga institucioni i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Tiranë si procese shumë të rëndësishme. Strukturat kryesore në bashki të cilat ndihmojnë në informimin e publikut dhe mbajnë e zhvillojnë marrëdhënien me publikun dhe mediat janë Zyrat e Informacionit; Koordinatori për të Drejtën e Informimit si edhe Zyrat me një ndalesë. Bashkia Tiranë i ndërton komunikimet publike me qytetarët nëpërmjet disa mënyrave si: komunikimi i drejtpërdrejtë, të cilin e zhvillon nëpërmjet takimeve në terren apo dëgjesave publike, komunikimi në mediave vizive, si dhe komunikimin në mediat sociale. Por, ajo çfarë del në pah është se shpesh qytetarët ankohen për mungesë informacioni, edhe pse bazuar në këtë raport, mekanizmat që bashkia përdor janë të shumtë dhe të llojeve të ndryshme.

Pavarësisht arritjeve të deritanishme, realizimi i procesit të konsultimit publik ka nevojë për më shumë. Të dhënat tregojnë se Bashkia e Tiranës përdor shumë mënyra, mekanizma dhe forma për të realizuar proceset e informimit publik dhe i përdor ato në kohë reale. Tani duhet parë mundësia për përçimin e informacionit tek çdo banor I Tiranës duke përdorur edhe njoftimet derë më derë, në ato raste kur e parashikon ligji. Kjo kërkon edhe rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t'u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Këshilli Bashkiak duhet të përditësojë rregullisht mediat (sidomos ato sociale) në mënyrë që ndikimi dhe informimi tek qytetarët të jetë sa më i madh. Miratimi i pesë rregulloreve të veçanta nga bashkitë e tjera duket sikur ka sjellë rezultat në mirëfunksionimin e tyre, ndoshta edhe Këshilli Bashkiak i Tiranës, mund të shikojë mundësinë e përshtatjes së tyre në përdorim edhe pse regullorja që përdor ky këshill është përmirësuar dhe përditësuar.

Ndërtimi i komunikimit të duhur me qytetarët siguron informimin, orientimin dhe përfshirjen demokratike të qytetarëve në qeverisjen vendore. Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë një nga aktivitetet më të rëndësishme në Bashki. Ato mundësojnë komunikimin me qytetarët për trajtimin e problematikave dhe çështjeve më interes për komunitetin, por për një sërë arsyesh pjesëmarrja në to është e pakët. Prandaj, shihet i nevojshmë përmirësimi i këtij aspekti, nëpërmjet konsultimit më të gjerë për marrjen e mendimit qytetarëve.

Në përputhje edhe me Ligjin 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*" Bashkia Tiranë e ka ndërtuar faqen zyrtare, një strukture e mirëfilltë për publikimin e informacioneve që lidhen me institucionin. Është një faqe e cila ofron informacion dhe është miqësore për përdoruesi.

Duke qenë se jo të gjithë qytetarët janë të familjarizuar me përdorimin e faqes zyrtare dhe aksesin e informacionit online, nevojitet informim i vazhdueshëm i qytetarëve nëpërmjet takimeve publike. Procesi i dixhitalizimit të shumë shërbimeve krijon vështirësi në aksesin e informacionit apo shërbimit për shumë qytetarë, prandaj duhet të vijojë zyra e informacionit për komunikim me të gjithë banorët.

- Njësitë Administrative duhet të marrin më shumë përgjegjësi dhe kompetenca;
- Aktivitetet e NJA (sidomos atyre që janë më larg qytetit) duhet të jenë në koherencë me aktivitetet që organizon bashkia dhe NJA që janë më afër qendrës;
- Të nxitet pjesëmarrja qytetare nëpërmjet strukturave të ndryshme në të gjithë bashkisë Tiranë, duke funksionuar si urë lidhëse: ndërlidhësit e komunitetit; kryepleqtë; administratorët e pallateve. Sa më sipër ata duhet të ndihmojnë që në të gjithë bashkinë Tiranë të mobilizojnë qytetarët, ti informojnë ata dhe ti përfshijnë në iniciativa qytetare për adresimin e kërkesave dhe shqetësimeve të tyre;
- Të ndërgjegjësohen qytetarët për rolin e tyre në vendimmarrje;
- Të bëhen publike në mënyrë të vazhdueshme rekomandimet e komunitetit që janë marrë parasysh gjatë procesit të konsultimit public të projekteve vendore.

IX. Referenca

- Faqe zyrtare e bashkisë Tiranë: https://tirana.al/
- Faqet zyrtare të mediave sociale të bashkisë Tiranë:
- https://twitter.com/CityOfTirana
- https://www.facebook.com/bashkia.tirane.al/
- https://www.instagram.com/bashkiatirane/
- https://www.youtube.com/user/MEDIAERIONVELIAJ
- Faqe zyrtare në mediat sociale të kryetarit të bashkisë Z. Erion Veliaj
- Faqe zyrtare e Këshillit Bashkiak në Facebook: https://www.facebook.com/profile.php?id=100063702506234
- Aplikacioni Open Data bashkia Tiranë: https://opendata.tirana.al/
- Platforma Kombëtare ku publikohen vendimet e këshillave bashkiakë të Republikës së Shqipërisë: https://www.vendime.al/
- Portalin e të dhënave të hapura: http://opendata.gov.al/
- Ligjin nr.115/2014 për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.
- Ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”
- Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”
- Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike.

X. ANEKS 1 PYETËSOR ME DREJTUES DHE NËPUNËS TË BASHKISË

Bashkia _____
Drejtoria _____

1. Në opinionin tuaj si drejtues/nëpunës, sa i rëndësishëm është njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore?

Perceptimi	Shumë i rëndësishëm	I rëndësishëm	Disi i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Aspak i rëndësishëm
Njoftimi	1	2	3	4	5
Informimi	1	2	3	4	5
Konsultimi	1	2	3	4	5

2. A e njihni bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore?

Njohuritë	Shumë mirë	Mirë	Disi	Pak	Aspak
Kuadri ligjor	1	2	3	4	5

3. Cili është vlerësimi juaj për kuadrin ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor? (mund të zgjidhni më shumë se sa një alternativë)

   □ Është i qartë dhe i plotë
   □ Është i qartë, por jo i plotë
   □ Është i paqartë, por i plotë
   □ Është i paqartë dhe jo i plotë

4. Nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja në këtë drejtim?

_____
_____
_____

5. A ka koordinator/e për njoftimin dhe konsultimin publik në Bashki dhe a është ky i vetmi pozicion që mbulon?

   Po □ Jo □

6. A ka koordinator/e për transparencën në Bashki dhe a është ky i vetmi pozicion që mbulon?

   Po □ Jo □

7. Cilat janë mjetet që përdorni për njoftimin e qytetarëve për përfshirjen e tyre në vendimarrje? Ju lutem specifikoni (mund të bëni më shumë se një zgjedhje).

   □ Lajmërim publik afishuar në ambjentet e bashkisë
   □ Lajmërim në mediat audio-vizive lokale
   □ Lajmërim në mediat sociale (Facebook, etj)
   □ Lajmërim individuale përmes postës
   □ Lajmërim individuale përmes postës elektronike
   □ Tjetër

8. Sa njoftime të publikuara në tabelat e lajmërimeve dhe online janë bërë gjatë vitit 2021? Ju lutem specifikoni.

_____
_____
_____

9. A keni regjistër elektronik dhe a përditësohet ai sistematikisht?

   Po □ Jo □

10. Kush është përgjegjës për përditësimin e tij?

_____
_____

11. A është i publikuar ky regjistër (online)?

Po □ Jo □

12. Cilat nga mjetet dhe format e mëposhtme përdorni për informimin e qytetarëve. Ju lutem specifikoni (mund të bëni më shumë se një zgjedhje):

□ Zyrat me Një Ndalesë (One Stop Shop)
□ Këndet e informimit në ambjentet e bashkisë/njësive administrative
□ Faqja zyrtare e bashkisë
□ Regjistri elektronik
□ Mediat sociale
□ Botimet e bashkisë
□ Materiale informuese (fletë palosje, etj)
□ Mediat audio-vizive lokale
□ Tjetër

13. A kanë mundësi qytetarët të marrin apo aksesojnë lehtësisht dokumenta dhe/apo informacione që ju duhen pranë bashkisë?

Po □ Jo □

14. A publikohen aktet e Bashkise Tuaj në faqen zyrtare të internetit?

Po □ Jo □

15. A afishohen aktete e bashkisë tuaj në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.

Po □ Jo □

16. A keni hartuar dhe publikuar programin e transparencës?

Po □ Jo □

17. A keni hartuar dhe/apo publikuar raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes?

Po □ Jo □

18. Nëse po, a përfshijnë ato informacion mbi:

□ numrin e akteve të miratuara nga Bashkia përgjatë vitit;
□ numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
□ numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
□ numrin e takimeve publike të organizuara.

19. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur për njoftimin dhe informimin e publikut?

_____
_____
_____

20. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

_____
_____
_____

21. A keni marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik?

Po □ Jo □

22. Cilat do të ishin nevojat për trajnime në te ardhmen në lidhje me informimin publik, njoftimin dhe konsultimin?

_____
_____

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

XI. ANEKSI 2 PYETËSOR ME KËSHILLIN BASHKIAK

Bashkia _____

1. Në opinionin tuaj si këshilltar vendor, sa i rëndësishëm është njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore?

Perceptimi	Shumë i rëndësishëm	I rëndësishëm	Disi i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Aspak i rëndësishëm
Njoftimi	1	2	3	4	5
Informimi	1	2	3	4	5
Konsultimi	1	2	3	4	5

2. A e njihni bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore?

Njohuritë	Shumë mirë	Mirë	Disi	Pak	Aspak
Kuadri ligjor	1	2	3	4	5

3. Cili është vlerësimi juaj për kuadrin ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor?
   - □ I qartë dhe i plotë
   - □ I qartë, por jo i plotë
   - □ I paqartë, por i plotë
   - □ I paqartë dhe jo i plotë

4. Keni rregullore dhe procedura të brendshme të miratuara për realizimin e procesit njoftimit dhe informimit? Nëse po, ju lutem specifikoni.
   _____
   _____
   _____

5. Cili është vlerësimi juaj për rregulloret e Këshillit Bashkiak ("Marrëdhënjet e KB me publikun dhe median" dhe "Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare")?

□ Të qarta dhe të plota
□ Të qarta, por jo të plota
□ Të paqarta, por të plota
□ Të paqarta dhe jo të plota

6. Nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja në këtë drejtim?

_____
_____
_____

7. A ka bashkëpunim mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e njoftimit dhe informimit?

Po □ Jo □

8. Nëse po, si realizohet ky bashkëpunim?

_____
_____
_____

9. A publikohet njoftimi për mbledhjen e këshillit në vende të caktuara për këtë qëllim dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore

Po □ Jo □

10. Ne dijeninë tuaj, a përmban njoftimi datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes?

Po □ Jo □

11. Në dijeninë tuaj aktet e Këshillit Bashkiak publikohen/shpallen në:

□ faqen zyrtare të internetit
□ në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik
□ tjetër

12. A ka Këshilli Bashkiak burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit te publikut?

Po □ Jo □

13. Në dijeni tuaj, cilat janë mjetet që përdor Këshilli për njoftimin dhe informimin e publikut:

□ Lajmërim publik afishuar në ambjentet e bashkisë
□ Lajmërim në mediat audio-vizive lokale
□ Lajmërim në mediat sociale (Facebook, etj)
□ Lajmërim individuale përmes postës apo takimeve direkte
□ Lajmërim individuale përmes postës elektronike
□ Tjetër

14. Në dijeninë tuaj, a ka një regjistër elektronik të publikuar dhe përditësuar rregullisht?

Po □ Jo □

15. Në dijeninë tuaj, a ka hartuar dhe publikuar Bashkia programin e transparencës?

Po □ Jo □

16. Në dijeninë tuaj, a hartohen dhe publikohen raporte vjetore të punës së Këshillit për transparencën në procesin e vendimmarrjes?

Po □ Jo □

17. A keni marë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik?

Po □ Jo □

18. Cilat do të ishin nevojat për trajnime në te ardhmen në lidhje me informimin publik, njoftimin dhe konsultimin?

_____

_____

_____

FALEMINDERIT!

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy." Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë;
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
Qendra Rinore Vlorë,
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
Epoka e Re, Fier;
Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
Qendra Rinore për Progres, Kukës,
Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
Gruaja në Zhvillim, Korçë;
Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
Tjetër Vizion, Elbasan